



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEQA"

Syllabus – Ndërmarrësia dhe Inovacionet

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Ndërmarrësia dhe Inovacionet
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II (Sems. III)
Numri i orëve në javë	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ofron një hyrje në konceptet dhe aftësitë e nevojshme për të komercializuar me sukses ide të reja; identifikimin e mundësive të mira dhe pastaj krijimin, komunikimin dhe kapjen e vlerës nga këto mundësi. Kjo lëndë përfshin edhe inovacionin në mjediset e korporatave dhe mjediset jofitimprurëse. Thëks I veçantë do të vendoset në formimin e një ndërmarrjeje të re. Kjo lëndë gjithashtu shqyrton strategjitë e suksesshme, modelet e biznesit, kornizat, financimet, pengesat dhe rreziqet për të prezantuar produkte dhe shërbime depërtuese. Temat përfshijnë inovacionin e modelit të biznesit, udhëheqje strategjike, inovacionin e orientuar kah njeriu, menaxhimin e njohurive dhe ndryshimeve.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim njoftimin e studentëve në procesin e fillimit të një ndërmarrjeje apo iniciative të re në çfarëdo industrie. Gjithashtu të zhvilloj tek studentët aftësi dhe njohuri për vlerësimin, artikullimin, përpunimin dhe futjen e një produkti apo shërbimi të ri në treg, qoftë si një biznes fillestar ose një nismë e re brenda një firme ekzistuese.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohuri (NJ): *NJ1: Zotëron njohuri të avancuara mbi parimet e ndërmarrësisë dhe inovacionit dhe aplikimin e tyre në kontekste të ndryshme të industrive. *NJ2: Përdor teoritë dhe praktikën bashkëkohore të inovacionit për të artikuluar konceptet e zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve të reja. *NJ3: Njohuri mbi strategjitë e analizës së mundësive të tregut dhe potencialit të industrisë për sipërmarrje të reja.

	Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1: Analizon dhe vlerëson me kritikizëm mundësitë e biznesit dhe burimet e kërkuara për suksesin e tyre, duke përfshirë përzgjedhjen e burimeve financiare të duhura. **A-K2: Zhvillon dhe zbaton një model biznesi për një sipërmarrje të re, i cili reflekton analizën e tregut dhe nevojat e konsumatorëve. **A-K3: Kryen kërkime të avancuara mbi tendencat e tregut dhe konkurrencën për të vlerësuar atraktivitetin e një industrie dhe pozicionin e mundshëm të një nisme të re. **A-K4: Harton një plan biznesi të qartë, bindës dhe të strukturuar që përfshin objektiva, strategji operacionale dhe analizë financiare. **A-K5: Përdor metoda të menaxhimit strategjik për të zhvilluar projekte sipërmarrëse dhe inovative brenda konteksteve të ndryshme të tregut. **A-K6: Zbaton teknika të avancuara të menaxhimit të inovacionit për të drejtuar procese krijimi dhe komercializimi të produkteve ose shërbimeve të reja. Aftësi (A): ***A1: Mendon në mënyrë kritike dhe krijuese mbi mundësitë e biznesit, burimet dhe strategjitë e inovacionit për të identifikuar zgjidhje të qëndrueshme dhe të përshtatshme për tregun. ***A2: Përshkruan procesin e komercializimit dhe menaxhimit të inovacionit, përfshirë fazat kryesore nga konceptimi deri te realizimi në treg. ***A3: Zhvillon dhe prezanton në mënyrë bindëse plane dhe strategji biznesi për të mbështetur rritjen dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve të reja. ***A4: Bashkëpunon në mënyrë efektive dhe udhëheq me kompetencë ekipet sipërmarrëse, duke demonstruar aftësi në koordinimin e roleve dhe burimeve. ***A5: Identifikon dhe përdor teknika analitike për të vlerësuar performancën dhe ndikimin e një nisme të re në treg. ***A6: Prezanton dhe argumenton strategji të përshtatshme për financimin e sipërmarrjeve të reja në mënyrë profesionale dhe bindëse. Sqarim: Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së.
--	---

	*Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	10	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	1	5	5
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	11	11
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	2	6
Projektet,prezentim	2	2	4
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	- Metoda e punës do të përmbaj ligjërime teorike edhe ato praktike duke përfshirë këtu punën individuale e në veçanti atë grupore. - Studentët do të përballen me gjetjen e rezultateve më të mira për përballje me raste të ndryshme duke e luajtur rolin e ndermarresit, do të përballen me raste konkrete të cilat do t'i ndihmojnë atyre që të jenë të gatshëm për ndermarje biznesore ne fusha apo drejtime te caktuara. - Metodologjia perfshin prezantimin e i temës mësimore, rast studimi apo detyrë lidhur me temën e ligjëruar dhe diskutim mbi te. - Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime		
Metodat e vlerësimit:	- Vijueshmëria 10% - Testi I 20 % - Kanvasi I Modelit të Biznesit 10% - Plani I Biznesit 10% - Provimi përfundimtar 50%		
Literatura			
Literatura bazë:	- Veland Ramandani (2024) Ndërmarrësia e Qendrueshme, Universiteti i Evropës Juglindore.		

	- Peter F. Drucker: Inovacioni dhe Ndërmarrësia, Shtëpia Botuese e Librit Universitar 2010, Tirane.
Literatura shitesë:	- The Lean Startup: How Today's Entrepreneurs Use Continuous Innovation to Create Radically Successful Businesses. Eric Ries, 2011. - Veland Ramandani, Robert D. Hisrich, Nora Sadiku – Dushi, Shqipe Gërguri – Rashiti (2022) – Ndërmarrësia dhe Menaxhimi i Biznesit të Vogël, Universiteti i Evropës Juglindore. - Geoffrey Jones (2017) – Profits and Sustainability - A History of Green Entrepreneurship, University of Oxford, 2017. - Blue Ocean Strategy, R. Mauborgne. Harvard Business School Press, 2015. - The Startup Owner's Manual: The Step-By-Step Guide for Building a Great Company. Steve Blank, Bob Dorf, 2012 - Bazat e Sipërmarrjes, Marsela Robo, Andrea Xhavara, Tirane 2012. - Charles Bamford, Garry Bruton, 2021, Entrepreneurship: The Art, Science, and Process for Success, Fourth Edition, MC Graw Hill, Texas Christian University

Plani i dizejnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	- Hyrje në Inovacion dhe Ndërmarrësi - Njohje me lëndën
Java e dytë:	- Orientimi i të menduarit ndërmarrës
Java e tretë:	- Menaxhimi I Inovacionit
Java e katërt:	- Krijimtaria dhe të menduarit krijues
Java e pestë:	- Identifikimi dhe vlerësimi I mundësive
Java e gjashtë:	- Strukturat e tregut dhe të Industrisë
Java e shtatë:	- Strategjia dhe modelet e biznesit
Java e tetë:	- Financat dhe ndërmarrësia
Java e nëntë:	- Testi intermediar
Java e dhjetë:	- Menaxhimi ndërmarrës
Java e njëmbëdhjetë:	- Planet e biznesit
Java e dymbëdhjetë:	- Përgaditja dhe menaxhimi i ndërmarrjes
Java e trembëdhjetë:	- Negocimi me ofrues të burimeve
Java e katërmëdhjetë:	- Bazat ligjore dhe ndërmarrësia
Java e pesëmbëdhjetë:	- Nga ideja tek realizimi – Përmbledhje e menaxhimit të inovacionit dhe ndërmarrësisë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;

- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.

Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.